



Prishtinë, 27.02.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3090_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2815_12_25** i datës 12.12.2025;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës 09.02.2025.

në seancën e mbajtur më datë **27.02.2026** nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** Kundërshtimi i KESCO-s, ndaj Vendimit të DMK-së për konsumatorin **F. M.**, me shifër DPR - 90185864, si i pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2815_12_25 i datës 12.12.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 12.12.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2815_05_25 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar ankesën e konsumatorit F. M., lidhur me kontestimin e faturës me nr. 04250DPR – 90185864 e dt. 22.04.2025 dhe korrigjimin financiar me nr. 1074143DPR – 90185864 i dt. 25.04.2025, në vlerë prej -76.87 €, dhe se është obliguar KESCO-ja që të bëjë korrigjimin financiar për periudhën 06/2024 – 04/2025 në vlerë prej -156.46 €.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, Furnizuesi KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Korrigjimi financiar në vlerë prej -76.87 €, është në përputhje të plotë me rregullat në fuqi;
- Njehsori elektrik me nr. 86000973 i ka ruajtur të dhënat e regjistruara dhe shpërndarja e kËh të shpenzuar është bërë për periudhën 06/2024 – 04/2025, sipas gjendjeve të regjistruara në njehsor, periudhë për të cilën njehsori i ka ruajtur të dhënat;
- Shpërndarja e kËh sic është aplikuar në vendimin e kontestuar, nuk është e arsyeshme, sepse, njehsori AMR me lexim nga distanca, që i ruan të dhënat ditore;
- Departamenti për konsumatorë në KESCO, kërkon nga Bordi i ZRrE-së, pezullimin e Vendimit të DMK-së me nr. ZRrE/DMK_V_2815_12_25 i dt. 12.12.2025



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2025 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Kundërshtimin e KESCO-s të datës 09.02.2026; Vendimin e DMK-së të datës 12.12.2025; Vendimin e KESCO-s të datës 19.05.2025; Kërkesat e konsumatorit në KESCO; Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 26.06.2025; Transaksionet e konsumatorit, Rrjedhën e energjisë dhe Listat e Leximit, si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Kundërshtimi i KESCO-s **është i pabazuar**, sepse:

Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe analizimit të listave të leximit konstatohet se konsumatorit njehsori elektrik nr. 86000973 i është vendosur për matje në periudhën 06/2024 dhe se konsumatori nga kjo periudhë e tutje ka lexime dhe faturime përmes AMR-Lexim nga distanca. Në baze të listave të leximit po ashtu vërtetohet se, konsumatori nga periudha 06/2024 deri në periudhën 03/2025 nuk ka faturim të shpenzimeve reale mujore por që është faturuar pa matje-ne listat e leximit është evidentuar lexim CCP, kurse ne periudhën 04/2025 i është dërguar fatura me 9,367 kWh te grumbulluar e qe kjo ne asnjë rast nuk mund te paraqet shpenzim real te konsumatorit. Bordi thekson se, bazuar në shqyrtimin e rrjedhës së energjisë elektrike, listave të leximit, KESCO me rastin e faturimit të konsumatorit për shpenzimet e periudhës kontestuese, përfshi edhe faturën e periudhës prill 2025 (faturën nr. 04250DPR-90185864 date 22.04.2025), përkatësisht për periudhën qershor 2024 deri në periudhën prill 2025 ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji e ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar edhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

Bordi e ka shqyrtuar Korrigjimin Financiar me nr. 107414DPR-90185864 të datës 25.04.2025, të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO në vlerë prej -76.87€, në të cilin është evidentuar si vijon: *“Faturim i vlerësuar. Shpërndarje e kWh për periudhën 06/2024 deri 04/2025 duke u bazuar në leximet e AMR dhe rrjedhën e energjisë elektrike”,* dhe ka gjetur se, ky korrigjim është bërë duke nxjerrë të dhënat nga njehsori elektrik. Duke pasur parasysh se KEDS/KESCO edhe me herët, para dërgimit të faturës kontestuese nr. 04250DPR-90185864 date 22.04.2025 ka pasur mundësi që të bëjë ri faturimin e të gjitha faturave mujore sipas shpenzimeve të shkaktuara dhe të njëjtat të dërgohen tek konsumatori por që nuk e ka bërë një gjë të tillë duke mos respektuar nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, andaj, ka vendosur që konsumatorit duhet t'i bëhet korrigjimi financiar, duke bërë shpërndarjen e kWh për periudhën 06/2024 deri në periudhën 04/2025 në vlerë **-156.46€**.



Tutje, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se i licencuari KESCO në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Bordi pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët e ne veçanti rrjedhën e energjisë elektrike, listat e leximit, Procedurën e Leximit dhe Faturimit të konsumatorëve tariforë, si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s;
- Konsumatorit **F. M**;
- Arkivit të ZRrE-së.